



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 1, datë 20.12.2018

MBI

MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT DHE TË ZËVENDËSKRYETARIT TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 9 e Kushtetutës, nenin 59 pika 1 germa “ç” dhe nenin 97 pika 1 e ligjit nr. 115/2017 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

V E N D O S I:

1. Të miratojë rregullat për zgjedhjen e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RREGULLORE

PËR PROCEDURËN E ZGJEDHJES SË KRYETARIT DHE ZËVENDËSKRYETARIT TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Kjo rregullore është përgatitur bazuar në pikën 9, neni 147 të Kushtetutës, si dhe pika 1 e nenit 59 dhe germa ç) pika 1 e nenit 97 të Ligjit nr. 115/2017 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

1. Objekti i këtij akti është përcaktimi i procedurës për zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, këtej e tutje “Këshilli”, zgjidhen në mbledhjen e parë të Këshillit si dhe çdo herë që mandati i tyre si anëtar i Këshillit përfundon.
3. Votimi për Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin zhvillohet kur jo më pak se 7 anëtarë të Këshillit janë të pranishëm.
4. Në mbledhjen e parë të Këshillit, anëtari jogjyqtar më i vjetër në moshë, thërret dhe drejton fillimin e procesit të votimit për Kryetarin e Këshillit.
5. Procedura e votimit është e hapur. Kur kandidon vetëm një kandidat votimi kryhet nominalisht nga secili anëtar me deklaram me mikrofon. Kur në garë janë dy ose më shumë kandidat votimi kryhet me fletë votimi në të cilën shënohen emrat e kandidatëve. Pas përfundimit të votimit nga secili anëtar, drejtuesi i mbledhjes lexon secilën fletë votimi dhe jep rezultatin përfundimtar duke shpallur kandidatin fitues.
6. Çdo anëtar jogjyqtar mund të propozojë veten si Kryetar/Zëvendëskryetar i Këshillit.

7. Anëtari i Këshillit, i pranishëm në mbledhje, nuk mund të heqë dorë nga votimi, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë pengesa ligjore të tilla si konflikti i interesit ose pengesa të tjera në zbatim të ligjit për konfliktin e interesave ose të Kodit të Procedurave Administrative.
8. Anëtari i Këshillit voton vetëm për një anëtar jogjyqtar si Kryetar i Këshillit. Anëtari jogjyqtar i propozuar si Kryetar i Këshillit ka të drejtën e votimi për veten e tij/saj. Drejtuesi i seancës administron kërkesat për Kryetar dhe Zëvendëskryetar të Këshillit dhe i prezanton ato para anëtarëve.
9. Anëtari kandidat për t'u zgjedhur Kryetar, që ka marrë shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm zgjidhet Kryetari i Këshillit deri në përfundim të mandatit si anëtar i Këshillit.
10. Në rast se asnjë nga anëtarët jogjyqtarë nuk ka marrë shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, votimi përsëritet ndërmjet dy anëtarëve jogjyqtarë që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në qoftë se dy ose më shumë anëtarë jogjyqtarë kanë marrë të njëjtin numër votash, votimi përsëritet midis tyre.
11. Në rast se asnjë nga anëtarët jogjyqtarë nuk ka marrë shumicën e votave pas votimit të dytë, Kryetari zgjidhet me short ndërmjet dy anëtarëve jogjyqtarë që kanë marrë numrin më të madh të votave.
12. Edhe për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Këshillit ndiqet e njëjta procedurë si në rastin e zgjedhjes së Kryetarit.